



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

### VENDIM

### PËR NDALIMIN E NDEZJES SË FISHEKZJARRËVE DHE MJETEVE PIROTEKNIKE GJATË FESTAVE TË FUND VITIT

#### Neni 1

1. Me këtë Vendim, ndalohet ndezja e fishekzjarrëve dhe mjeteve piroteknike gjatë festave të fund vitit në hapësirat publike të komunës së Lipjanit si dhe në zonat e banuara përveq në hapësirën e tregut të gjelbërt që gjendet në rr. "Xhavit Kozhani" në Lipjan.

2. Ndalimi i ndezjes së fishekzjarrëve dhe mjeteve piroteknike bëhet më qëllim të mbrojtjes së ajrit dhe mjedisit nga ndotja si dhe mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve.

#### Neni 2

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe i njëjti do të publikohet në webfaqen zyrtare të Komunës.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Drejtorati i Inspeksionit të Komunës së Lipjanit dhe Stacioni policor në Lipjani.

1Nr. 352/01-62356  
Lipjan, më 20.12.2024

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti

